

Shoqata Nisma per Ndryshim Shoqeror ARSIS

1. Informacion Bazë

- Viti i Themelimit: 2016
- Statusi Ligjor: Organizatë joftimprurese
- Selia Qendrore: Rruga "Sali Butka", Pallati T.B.M, Shkalla 2, Apartamenti 1, Kati 1, Nj. Administrative nr. 7, Kodi Postar 1023, Tiranë, Shqipëri
- Faqja e Internetit: <http://www.nisma-arsis.org>
- Email kryesor i organizatës: info@nisma-arsis.org
- Telefoni kryesor i organizatës: +355698233113

2. Misioni

Misioni i NISMA ARSIS është të promovojë të drejtat, të ofrojë shërbime dhe zgjidhje të qëndrueshme për fëmijët, të rinjtë dhe familjet në situata të cenueshme, si dhe për komunitetet e marginalizuara Rome/Egjiptiane dhe grupe të tjera shoqërore në Shqipëri. Në këtë kuadër, NISMA ARSIS zhvillon metoda dhe mjete të reja për mbështetjen e fëmijëve dhe të rinjve, organizon dhe merr pjesë në rrjete për solidaritet social, si dhe bashkëpunon me shërbime publike dhe private.

3. Vizioni (Opsionale)

Vizioni i NISMA ARSIS është një shoqëri me mundësi të barabarta për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë, me respektimin e të drejtave të tyre, ashtu siç janë përcaktuar në legjislacionin shqiptar dhe atë ndërkombëtar, përmes Paktit të OKB-së për të Drejtat e Fëmijës.

4. Fushat Kryesore të Fokosit

1. Mbrojtja e Fëmijëve

- Forcimi i mekanizmave të mbrojtjes së fëmijëve në nivel kombëtar dhe lokal
- Strehim emergjent dhe shërbime për fëmijët pa kujdes prindëror dhe viktimat të dhunës

2. Drejtësia për Fëmijët

- Ofrimi i shërbimeve miqësore për fëmijët në konflikt me ligjin
- Mbështetje psikosociale në komisarate policie

3. Shërbime Sociale të Specializuara

- Riintegrimi familjar dhe zhvillimi i modeleve të kujdesit alternativ
- Deinstitutionalizimi i fëmijëve dhe mbështetje teknike për institucionet shtetërore

4. Minoritete (Romë dhe Egjiptianë)

- Arsimi gjithëpërfshirës dhe programet e zhvillimit të fëmijërisë së hershme
- Programi i "Shkollës Mobile" për komunitetet në nevojë

5. Mbështetje për Evakuetët Afganë

- Strehim, ndihmë psikosociale dhe orientim profesional
- Rehabilitim dhe riintegrim social dhe ekonomik

6. Trafikimi i Qenieve Njerëzore

- Parandalim dhe ndërgjegjësim për trafikimin
- Shërbime për viktimat dhe grupet në rrezik

7. Të Rinjtë

- Pjesëmarrje komunitare dhe ngritje kapacitetesh për të rinjtë
- Klube rinore për përfshirje qytetare dhe aktivitete psikosociale

8. Shërbime Multidisiplinare në Komunitet

- Qendra “Shtëpia me Ngjyra” në Tiranë për fëmijë dhe familje në nevojë
- Qendra për fëmijët kthyer nga migrimi në Selitë dhe Durrës

9. Reagimi Emergjent dhe Humanitar

- Strehim emergjent 24/7 për viktimat e dhunës dhe trafikimit
- Ndihmë humanitare për rastet e tërmeteve dhe pandemisë

10. Fuqizimi Ekonomik

- Trajnime për punësim dhe ndërmarrje sociale
- Mbështetje për familjet në nevojë për të ndërtuar qëndrueshmëri ekonomike

5. Aktivitetet/Programet Kryesore

- Projekti: “Shtëpia me Ngjyra” – Qendër Multidisiplinare për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Fëmijëve
Një qendër gjithëpërfshirëse në Tiranë që ofron mbështetje për fëmijët dhe familjet në nevojë përmes shërbimeve psikosociale, edukative, shëndetësore dhe ligjore. Qendra u shërben viktimave të dhunës, trafikimit dhe fëmijëve në rrezik ndarjeje nga familja. Aktiviteti i saj përfshin gjithashtu strehim emergjent 24/7 për fëmijët dhe nënat e tyre në situata të rrezikshme.

- Projekti: Forcimi i Mekanizmave Lokalë për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Riintegrimi i Kthyerve

Program i zbatuar në bashkëpunim me GCERF dhe institucione shtetërore, që synon ndërtimin e kapaciteteve të trupave lokalë për të parandaluar radikalizimin dhe për të riintegruar individët në rrezik. Aktivitetet përfshijnë ndërhyrje në nivel komuniteti, trajnime për punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve dhe krijimin e modeleve të bashkëpunimit ndër-institucional.

- Projekti/Programi 4: “Deinstitucionalizimi dhe Kujdesi Alternativ për Fëmijët”

Në bashkëpunim me UNICEF dhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, projekti synon mbylljen graduale të institucioneve rezidenciale për fëmijët dhe kalimin drejt kujdesit familjar, përmes riintegrit, kujdesit profesional me familje pritëse dhe ngritjes së qendrave të mbështetjes për fëmijët dhe familjet.

- Projekti: “Fuqizimi i të Rinjve si Agjentë të Ndryshimit” – Bashkia Kamëz

Program i zhvilluar me mbështetjen e UNDP, që përfshiu 600 të rinj në identifikimin e nevojave komunitare, ngritjen e rrjeteve rinore, trajnimin e edukatorëve bashkëmoshatarë dhe hartimin e një Plani Veprimi Lokal për Rininë.

6. Shtrirja Gjeografike

Shërbimi i Strehimit Emergjent të Sigurtë (e vendosur në “Shtëpinë e Ngjyrave” në Tiranë) ofron mbështetje për të gjithë fëmijët dhe nënat në nivel kombëtar që ndodhen në rrezik ose kanë përjetuar dhunë dhe abuzim. Ekipi i lëvizshëm i ofrit të shërbimit psiko-social në situatë emergjente, i cili aktivizohet për raste emergjente të mbrojtjes së fëmijëve, mbulon në mënyrë të përgjithshme gjithë territorin e vendit. Megjithatë, çdo situatë trajtohet individualisht, duke marrë parasysh disponueshmërinë e stafit dhe kapacitetet logjistike për transportin. Organizata, përmes programeve të saj të shumta dhe të ndryshme, është aktualisht prezente në bashkitë Tiranë, Elbasan, Durrës, Shkodër, Vlorë, Korçë, Cerrik,

Kavaje, Pogradec, Belsh, etj.. përmes zyrave të themeluara ose stafit të vendosur në terren. Mbështetja e organizatës për forcimin e kapaciteteve të profesionistëve të ndryshëm realizohet në gjithë territorin e vendit.

7. Udhëheqja

Drejtori Ekzekutiv/CEO: Ana Majko

Bordi i Drejtuesve: Vasilika Laci, Xheni Karaj, Sead Kazanxhiu, Borana Resulaj

8. Partneritetet dhe Bashkëpunimet (Opsionale)

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS ka ndërtuar partneritete të gjera me institucione publike dhe ndërkombëtare, duke krijuar një rrjet të fortë bashkëpunimi për të ofruar shërbime sociale dhe për të zbatuar politika gjithëpërfshirëse për mbrojtjen dhe fuqizimin e grupeve vulnerabël.

Partnerë Institucionalë Kombëtarë:

- **Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), Ministria e Brendshme, Bashkia Tiranë** (partner strategjik për më shumë se 14 vite), **Bashkitë e Durrësit, Vlorës, Korçës, Fierit, Kamzës, Lezhës, Elbasanit, etj.), Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Njësitë e Vlerësimit të Nevojave (NARU)**

Donatorë dhe Agjenci Ndërkombëtare:

- **UNICEF Albania, UNDP Albania, IOM Albania, GIZ (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit), GCERF (The Global Community Engagement and Resilience Fund), US Embassy in Tirana, Swisscontact, European Commission – Programi CERV, Vital Voices Global Partnership, Rockefeller Philanthropy Advisors, Schuler Helfen Leben (SHL), Save the Children Albania, Terre des Hommes. ASB – Arbeiter-Samariter-Bund, International Rescue Committee (IRC), ARISE Foundation, Erste Foundation**

Rrjete dhe Platforma Ndërkombëtare

- **Dynamo International Street Work Network, Mobile School International, IRIS Network for Social Services, RENATE Network, WeProtect Global Alliance, COPE Europe, PICUM (Platform for International Cooperation on Undocumented Migrants), EPA – European Playwork Association, European Union Agency for Asylum (EUAA), Global Modern Slavery Directory, International Police Organization**

9. Ndikimi (Opsionale)

- **90+ projekte** të zbatuara në 5 vitet e fundit në të gjithë Shqipërinë.
- **4000+ fëmijë** të prekur nga tërmeti dhe pandemia COVID-19 të mbështetur me ndihmë psikosociale, arsimore dhe materiale.
- **1500+ prindër** kanë marrë mbështetje psikosociale dhe informim për kujdesin ndaj fëmijëve në kohë emergjencash.
- **237 fëmijë** të vlerësuar në institucionet rezidenciale si pjesë e procesit të deinstitutionalizimit, në bashkëpunim me MSHMS.
- **13 fëmijë** të vendosur në kujdes alternativ familjar si rezultat i projektit për deinstitutionalizim.
- **600 të rinj** të angazhuar në hartimin e Planit të Veprimit Rinor në Bashkinë Kamëz.

- **300 të rinj** pjesë e një rrjeti aktiv për përfshirje qytetare dhe zhvillim komunitar.
- **100% kënaqësi** e shprehur nga përfituesit në vlerësimet pas programit, sipas të dhënave të brendshme të organizatës.
- **100+ punonjës të institucioneve publike** (punonjës socialë, oficerë policie, mësues) të trajnuar për menaxhimin e rasteve dhe për mbrojtjen e fëmijëve.
- **45 punonjës me kohë të plotë** në vitin 2024, përfshirë profesionistë të fushës sociale, edukimit dhe shëndetit.
- **3 qendra shërbimi multidisiplinar** në funksion: “Shtëpia me Ngjyra” në Tiranë, qendra për kthyerit në Durrës dhe qendra për fëmijët 0–8 vjeç në Selitë.

10. Lajmet e Fundit/Çmimet (Opsionale)

-